KB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 21441/1 prot. Vlorë, më 26.10.2026

PROJEKTVENDIM

Nr._____datë ____._____2026

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

"MBI RIAKTIVIZIMIN DHE ZGJATJEN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT DATË 10.09.2020 SI DHE DAKORDËSIMIN E DISA NDRYSHIMEVE LIDHUR ME DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSITE E PALËVE PËR DY OBJEKTET E BANIMIT QË NDËRTOHEN NGA EKB NË ZBATIM TË PROGRAMIT PËR BANESAT ME KOSTO TË ULËT NË BASHKINË VLORË"

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.2 shkronja a), neni 55 pika 6, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social" të ndryshuar, neni 7, 44 dhe 45, të "Marrëveshjes së bashkëpunimit mbi zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, BKU, në Bashkinë Vlorë" të nënshkruar midis Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkisë Vlorë, me Nr.1632/1prot., datë 10.09.2020 për EKB dhe Nr.7528prot., datë 10.09.2020 për Bashkinë Vlorë, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.38, datë 31.03.2026 "Për miratimin e zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave në lagjen "Kushtrimi", Rajoni nr.5 Vlorë, miratimin e sistemit të pikëzimit, nivelin minimal dhe maksimal të të ardhurave dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë familjet/individët që do përfitojnë nga ky program", pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike;

VENDOSI

I. Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit "Mbi riaktivizimin dhe zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së Marrëveshjes së Bashkëpunimit datë 10.09.2020, si dhe dakordësimin e disa ndryshimeve lidhur me detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve për dy objektet e banimit që ndërtohen nga EKB në zbatim të Programit të Banesave me Kosto të ulët në Bashkinë Vlorë".

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës & Investimeve Publike dhe Drejtoria Juridike.

III. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, neni 55, pika 6.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA VLORË

KRYETAR
Brunilda Mersini

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 21641 prot. Vlorë, më 06 10 .2026

RELACION

Për projektvendimin

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

"MBI RIAKTIVIZIMIN DHE ZGJATJEN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT DATË 10.09.2020 SI DHE DAKORDËSIMIN E DISA NDRYSHIMEVE LIDHUR ME DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSITE E PALËVE PËR DY OBJEKTET E BANIMIT QË NDËRTOHEN NGA EKB NË ZBATIM TË PROGRAMIT PËR BANESAT ME KOSTO TË ULËT NË BASHKINË VLORË"

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit "Mbi zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, BKU, në Bashkinë Vlorë" të nënshkruar midis Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkisë Vlorë, me shkresat Nr.1632/1prot., datë 10.09.2020 për EKB dhe Nr.7528prot., datë 10.09.2020 për Bashkinë Vlorë, është parashikuar që Enti Kombëtar i Banesave gjatë viteve 2020-2024 do të financojë dhe ndërtojë në lagjen "Kushtrimi", Rajoni Nr.5, Vlorë, dy objekte të tjera banimi me kosto të ulët dhe efiçencë energjie, me 8 kate (7 kate banimi dhe 1 kat përdhe si ambjente shërbimi) gjithsej 75 apartamente. Aktualisht është në fazën e punimeve për mbylljen përfundimtare të tyre.

Me shkresat Nr.14921prot., datë 15.09.2025 "Kërkesë për vënien në dispozicion të listës së familjeve që përfitojnë strehim në dy banesat e ndërtuara në qytetin e Vlorës", Nr.14921/1prot., datë 17.10.2025 "Kërkesë e përsëritur për vënien në dispozicion të listës së familjeve që përfitojnë strehim në dy banesat e ndërtuara nga EKB në qytetin e Vlorës" dhe Nr.446prot., datë 06.03.2026 Enti Kombëtar i Banesave ka kërkuar nga Bashkia Vlorë miratimin dhe vënien në dispozicion të listës së familjeve që do të përfitojnë strehim në këto apartamente. Për ushtrimin e kompetencave dhe fillimin e proçedurave të ndarjes nga strukturat përgjegjëse të bashkisë është përgatitur projektvendimi i miratuar në Këshillin e Bashkisë Vlorë me Vendimin Nr.38, datë 31.03.2026 "Për miratimin e zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave në lagjen "Kushtrimi", Rajoni nr.5 Vlorë, miratimin e sistemit të pikëzimit, nivelin minimal dhe maksimal të të ardhurave dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë familjet/individët që do të përfitojnë nga ky program".

Ndërkohë nga konstatimi në terren dhe komunikimi verbal me EKB Dega Vlorë, ndërtimi i apartamenteve nuk ka përfunduar, pasi për një periudhë disamujore ka pasur ndërprerje të punimeve nga firma ndërtuese.

Në këto kushte me shkresën tonë Nr. 7757/3prot., datë 09.07.2026 "Kërkesë", kemi kërkuar nga Enti Kombëtar i Banesave të na informojë në lidhje me fazën kur do të përfundojnë plotësisht punimet dhe kolaudimi i objekteve, për të qenë gati për strehimin e familjeve që do të miratohen nga Këshilli i Bashkisë Vlorë, por pa marrë ndonjë përgjigje për këtë.

Ndërkohë, nisur nga fakti se marrëveshjes së bashkëpunimit datë 10.09.2020 i ka përfunduar afati i vlefshmërisë, pasi në nenin 4 të saj është përcaktuar afati prej 4-vjetësh nga data e nënshkrimit të saj nga palët, me shkresën tonë Nr.14814prot., datë 21.07.2026 "Kërkesë për zgjatjen e afatit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, datë 10.09.2020 "Marrëveshje bashkëpunimi mbi zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët në Bashkinë Vlorë", i jemi drejtuar sërish Entit Kombëtar të Banesave pasi në këtë nen është parashikuar gjithashtu se vlefshmëria e marrëveshjes mund të zgjatet me mirëkuptimin dhe vullnetin e përbashkët të palëve, në rast se detyrimet e përcaktuara në të nuk janë përmbushur brenda afatit të parashikuar, konkretisht:

Megjithëse bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve tona ka qenë i vazhdueshëm dhe shumë i mirë, si dhe është bërë progres në një sërë procesesh të rëndësishme, disa prej elementeve thelbësorë të marrëveshjes mbeten ende të papërfunduar;

1. Në dy objektet e banimit nuk janë kryer plotësisht punimet dhe për rrjedhojë, nuk është realizuar ende proçesi i kolaudimit teknik dhe regjistrimit.
2. Nuk është miratuar ende lista e familjeve përfituese të programit të strehimit.
3. Për shkak të mospërfundimit të ndërtimeve nuk mund të realizohet procesi i shitblerjes së 20 apartamenteve për blerjen e të cilave nga ana e Bashkisë Vlorë është rënë dakord ndërmjet palëve.
4. Nuk kanë filluar ende punimet për sistemimin dhe ndërtimin e infrastrukturën përkatëse të zonës.

Në vijim të komunikimit dhe në përgjigje të kërkesave për çështjet e pazgjidhura, EKB me shkresën Nr.735/3prot.; datë 05.08.2026, ka shprehur në parim dakordësinë lidhur me kërkesat, duke parashtruar realizimin e një draft marrëveshjeje ku do të pasqyrohen kërkesat dhe kushtet e dakordësuara, marrëveshje që do të shqyrtohet për miratim nga Këshilli Drejtues i EKB-së dhe nga Këshilli Bashkiak Vlorë.

Mbas hartimit, marrëveshja e nënshkruar me Nr.18591prot., datë 15.09.2026 për Bashkinë Vlorë dhe Nr.1323/4prot., datë 21.10.2026 për Entin Kombëtar të Banesave, vjen për miratim në Këshillin e Bashkisë Vlorë.

Sa më lart, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Vlorë, të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit "Mbi riaktivizimin dhe zgjatjen e afatit të vlefshmërisë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit "Mbi zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët, BKU, në Bashkinë Vlorë datë 10.09.2020, si edhe dakordësimin e disa ndryshimeve lidhur me detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve për dy objektet e banimit që ndërtohen nga EKB në zbatim të programit të Banesave me Kosto të Ulët në Bashkine Vlorë ". Bashkëlidhur po vendosim kopje të marrëveshjes.

Specialiste

Drita Mustafai

DREJTOR

Kristaq Jorgaqi

18591/2

23.10.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1323/3 prot.

Tiranë, më 21.10.2026

Lënda: Mbi vijimin e procesit të bashkëpunimit lidhur me dy objektet e banimit në qytetin e Vlorës.

BASHKISË VLORË
Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë

Në vijim të shkresave tuaja me nr.prot. 18591/1 datë 15.09.2026 dhe nr.prot.18717 datë 16.09.2026, protokolluar me tonën nr.prot. 1323/2 datë 21.09.2026 dhe nr.prot. 1452 datë 21.09.2026, ju bëjmë me dije se Enti Kombëtar i Banesave mbetet i gatshëm për vijimin e bashkëpunimit dhe ecurinë e këtij procesi si dhe miratimin e draft marrëveshjes së dakordësuar paraprakisht nga të dy institucionet tona, siç kemi theksuar edhe me korrespondencën e mëparshme të dërguar nga ana jonë me nr.prot. 1323/1 datë 03.09.2026.

Pikërisht për këtë qëllim, kjo draft marrëveshje do të prezantohet së afërmi në mbledhjen e radhës së Këshillit Drejtues të EKB-së për shqyrtim dhe miratim, dhe po kështu do të duhet të miratohet edhe nga Këshilli Bashkiak Vlorë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Besmir Hysa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT ENTI KOMBËTAR I BANESAVE TIRANË

Adresa: Rr. e Kavajës, ndërtesa nr.80, hyrja 1, kati 5 (ish shtëpia botuese "Naim Frashëri"), Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42 227 796, email: info@ekb.gov.al; www.ekb.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PROTOKOLL-ARKIVËS

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues G.V.K.B. TR, Nr.Prot 1393 Data 21.10.2026

Shkurtimi i lëndës Mbi vijimin e procesit

Për trajtim nga :	Klie
(struktura të tjera të ngarkuara	
Me porosi:	Ku mos ju KB kto

Afati : ☐ Normal 7 ditë/ ☐ Prioritet 3 ditë/ ☐ urgjent brenda ditës/ ☐ pa afat/për dije/Tjetër __ ditë

Data 23.10 2026, Nr. Prot 18591, Nënshkrimi : (TITULLARI) _____

Marrë në dorëzim : ___.___. 2026 Nënshkrimi : _____
Kalon për trajtim (struktura) : _____ ___.___.2026
Me porosinë : _____

Marrë në dorëzim : ___.___. 2026 Nënshkrimi : _____
Kalon për trajtim (struktura) : _____ ___.___.2026
Me porosinë : _____

Marrë në dorëzim : ___.___. 2026 Nënshkrimi : _____
Kalon për trajtim Specialistit : _____ ___.___.2026
Me porosinë : _____

Trajtimi i materialit përfunduar më : ___.___2026 Specialisti
Trajtimi i materialit pranuar më : ___.___2026 Eprori në shkallë hierarkike
Trajtimi i materialit miratuar më : ___.___2026 Eprori në shkallë hierarkike
Trajtimi i materialit miratuar më : ___.___2026 Eprori në shkallë hierarkike

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI KOMBËTAR I BANESAVE
Nr 1323/4 prot.
21/10/2026

BASHKIA VLORË
Nr 1859/1 prot.
15/09/2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MBI RIAKTIVIZIMIN DHE ZGJATJEN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT DATË 10.09.2020 SI DHE DAKORDËSIMIN E DISA NDRYSHIMEVE LIDHUR ME DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSITE E PALËVE PËR DY OBJEKTET E BANIMIT QË NDËRTOHEN NGA EKB NË ZBATIM TË PROGRAMIT PËR BANESAT ME KOSTO TË ULËT NË BASHKINË VLORË

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjin nr.22/2018, datë 03.05.2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar, si dhe në përputhje me Vendimin Nr.198 datë 04.05.1993 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave", i ndryshuar, si dhe mbështetur në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe Entit Kombëtar të Banesave me nr.prot.1632/1 datë 10.09.2020 dhe nr.prot.7528 datë 10.09.2020, duke synuar arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, EKB dhe Bashkia Vlorë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë deklarojnë dhe bien dakord si më poshtë :

Sot në datën 15/09/2026 lidhet kjo shtesë-marrëveshje bashkëpunimi, ndërmjet palëve:

- **Enti Kombëtar i Banesave**, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Besmir Hysa;

dhe

- **Bashkia Vlorë**, përfaqësuar nga Kryetar znj. Brunilda Mersini.

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Enti Kombëtar i Banesave dhe Bashkia Vlorë me lidhjen e kësaj marrëveshje kanë si qëllim dhe shprehin dakordësinë e tyre për sa më poshtë:

Meqënëse:

- Afati i Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në datën 10.09.2020 midis Bashkisë Vlorë dhe Entit Kombëtar të Banesave ka përfunduar dhe aktualisht nuk janë përmbushur ende të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë e marra përsipër nga palët;

- Bashkia Vlorë ka kërkuar ndryshime lidhur me interesin e shprehur në marrëveshjen bazë të sipërcituar duke hequr dorë nga blerja e njësive të shërbimit dhe duke kërkuar blerjen e 20 apartamenteve tek dy objektet e banimit Vlora 2, për qëllime sociale në funksion të zbatimit të progameve sociale të strehimit që aplikohen nga kjo bashki; dy institucionet si palë e kësaj marrëveshje që lidhet ndërmjet tyre ndajnë vullnetin e përbashkët për të vazhduar bashkëpunimin, me qëllim zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së marrëshjes bazë të lidhur në vitin 2020 duke lënë kryesisht në fuqi kushtet e kësaj marrëveshje për shkak se disa elementë thelbësorë mbeten ende të papërfunduar dhe vendosjen e tyre në afate të rinj kohorë, por duke dakordësuar dhe realizuar edhe ndryshimin e disa kushteve të tjera, referuar kërkesës së parashtruar me korrespondencë zyrtare nga Bashkia Vlorë.

Neni 2

Objekti i Marrëveshjes

KJo marrëveshje lidhet në vijim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me nr.prot. 1632/1 datë 10.09.2020 dhe nr.prot. 7528 datë 10.09.2020, ndërmjet EKB dhe Bashkisë Vlorë dhe ka si objekt riaktivizimin në zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes së sipërcituar në funksion të përmbushjes së detyrimeve që kanë mbetur të parealizuara, si dhe reflektimin e disa ndryshimeve që rrjedhin nga kërkesat e prezantuara nga Bashkia Vlorë për blerje të 20 apartamenteve të banimit për t'i përdorur për qëllime sociale, në objektet që ndërtohen nga EKB në qytetin e Vlorës në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit.

Neni 3

Zgjatja e afatit dhe riaktivizimi i detyrimeve të papërmbushura të palëve

a) Enti Kombëtar i Banesave dhe Bashkia Vlorë bien dakord për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet palëve me nr.prot.1632/1 datë 10.09.2020 (EKB) dhe nr.prot.7528 datë 10.09.2020 (Bashkia Vlorë), duke filluar nga data që ka përfunduar afati i parashikuar në këtë marrëveshje datë 11.09.2024 deri në datën 31.12.2027.

b) Palët dakordësojnë zgjatjen e afatit nga data 11/09.2024, duke marrë parasysh se bashkëpunimi dhe ndërveprimet kanë vazhduar edhe pas datës së mbarimit të marrëveshjes së sipërcituar dhe deri në nënshkrimin e kësaj marrëveshje dhe si rrjedhojë të gjitha veprimet e kryera në periudhën ndërmjet këtyre datave në zbatim të detyrimeve dhe përgjegjësive të marra përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit të sipërcituar, konsiderohen të vlefshme referuar kushteve të parashikuara nga marrëveshja e bashkëpunimit e lidhur më parë ndërmjet palëve.

c) Në vijim të përmbushjes së detyrimeve dhe përgjegjësive të marra përsipër, palët bien dakord dhe marrin përsipër që do të kryejnë të gjitha korrespondencat dhe miratimin e procedurave të nevojshme ligjore dhe teknike deri në regjistrimin e dy objekteve të banimit në ASHK.

Neni 4

Heqja dorë nga e drejta për blerje të ambienteve të shërbimit për qëllime sociale

Bashkia Vlorë heq dorë nga blerja e paracaktuar e ambienteve të shërbimit, përcaktuar në nenin 2 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr.prot.1632/1 datë 10.09.2020 dhe nr.prot.7528 datë 10.09.2020, pasi i ka vlerësuar si të papërshtatshme blerjen dhe përdorimin e tyre me destinacion kopësht ose çerdhe fëmijësh.

Neni 5

Kushtet dhe kriteret kryesore për blerjen e apartamenteve të banimit për qëllime sociale

a) Bashkia Vlorë merr përsipër blerjen e 20 apartamenteve për qëllime sociale nga totali prej 75 apartamente të dy objekteve të banimit ndërtuar nga EKB, në funksion të krijimit të fondit publik të banesave sociale, miratuar paraprakisht me Vendimin Nr.38, datë 31.03.2026 të Këshillit të Bashkisë Vlorë.

b) Apartamentet që do të blihen nga Bashkia Vlorë sipas kërkesës së kësaj të fundit do të jenë:
- 2 apartamente garsonierë;
- 2 apartamente (3+1);
- 6 apartamente (1+1);
- 10 apartamente (2+1).

Objekti i banimit, kati, numri i apartamentit dhe sipërfaqet takuese përkatëse që do të blihen nga Bashkia Vlorë përcaktohen me dakordësinë e palëve.

c) Bashkia Vlorë merr përsipër që të likuidojë të gjitha pagesat sipas vlerave përfundimtare të tyre që do të përllogariten nga EKB, si dhe shpenzimet noteriale dhe hipotekore, duke ofruar njëkohësisht edhe garancitë e nevojshme për blerjen e tyre duke lidhur paraprakisht edhe kontratë sipërmarrje (porosie).

ç) Pagesa për këto apartamente mund të realizohet në mënyrë të menjëhershme ose me këste (mujore, 3 mujore ose 6 mujore), sipas dakordësimit ndërmjet palëve, me një afat maksimal shlyerje deri në 5 vjet. EKB aplikon një normë fitimi 6% mbi koston përfundimtare të apartamenteve, si dhe interesin vjetor 3% në rastin kur blerja e apartamenteve nga Bashkia Vlorë do të bëhet me këste.

d) Në rast të moslikujdimit të detyrimeve nga Bashkia Vlorë sipas kushteve dhe afateve që përcaktohen në kontratat e shitjes, nga EKB do të aplikohet një penalitet 3/1000 për çdo ditë vonesë të kështit të radhës.

dh) Nëse Bashkia Vlorë në momentin e njoftimit zyrtar nga EKB nuk do të shprehë dakordësinë apo do të refuzojë lidhjen e kontratës/kontratave të shitjes për këto apartamente banimi pas

njoftimit zyrtar që i dërgon EKB lidhur me të dhënat dhe vlerat përkatëse për lidhjen e kontratave të shitjes, pas kalimit të afatit dy mujor nga data e këtij njoftimi ato do t'i shiten familjeve të pastreha që miratohen me vendimmarrje të Këshillit Bashkiak Vlorë në zbatim të programit të banesave me kosto të ulët.

e) Bashkia Vlorë merr pësipër të miratojë me vendim të Këshillit Bashkiak listën emërore të familjeve përfituese për këto apartamente dhe t'ja përcjellë Entit Kombëtar të Banesave, brenda dy muajve nga kërkesa e EKB-së për dërgimin e kësaj liste të miratuar.

f) Pas kalimit të afatit dymujor dhe në mungesë të miratimit të listës emërore nga Bashkia Vlorë, EKB rezervon të drejtën për shitjen e këtyre apartamenteve në treg të lirë sipas kritereve që do të miratohen dhe përcaktohen nga Këshilli Drejtues i EKB-së.

Neni 6

Garancia mbi pronën dhe tjetërsimi (kalimi) i pronësisë

a) Pronësia mbi apartamentet që i shiten Bashkisë Vlorë së bashku me truallin përkatës, regjistrohen në ASHK në emër të Entit Kombëtar të Banesave, me kushtin përkatës për mostjetërsim në favor të Bashkisë Vlorë.

b) Pas përfundimit të shlyerjes së gjithë vlerës së detyrimit për secilin apartament nga Bashkia Vlorë, EKB do të kryejë procedurat për kalimin e pronësisë së këtyre pasurive në emër të kësaj Bashkie, sipas përcaktimeve ligjore të parashikuara në kontratat përkatëse të shitjes.

Neni 7

Dispozita të Përgjithshme

a) Kjo marrëveshje do të konsiderohet si pjesë përbërëse dhe e pandarë e Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. prot 1632/1 datë 10.09.2020 (EKB) dhe nr. prot. 7528 datë 10.09.2020 (Bashkia Vlorë).

b) Nenet apo pikat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr.prot 1632/1 datë 10.09.2020 (EKB) dhe nr.prot. 7528 datë 10.09.2020 (Bashkia Vlorë), që preken nga kjo marrëveshje apo bien në kundërshtim me të, do të konsiderohen të shfuqizuara. Në vijim, çdo nen apo pikë tjetër e Marrëveshjes së Bashkëpunimit datë 10.09.2020 do të mbeten të pandryshuara dhe në fuqi deri në përfundimin e afatit të parashikuar në këtë marrëveshje.

Neni 8

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

a) Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe:
- dy kopje për Drejtorinë e Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave;

- dy kopje për Bashkinë e qytetit Vlorë.

b) Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi të jetë miratuar paraprakisht me vendimarrje nga Këshilli Drejtues i EKB-së dhe nga Këshilli Bashkiak i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, si dhe me nënshkrimin e saj nga palët përkatëse. (Drejtori i Përgjithshëm i EKB-së dhe Kryetari i Bashkisë).

Për Entin Kombëtar të Banesave

Drejtor i Përgjithshëm

Besmir Hysa

Për Bashkinë Vlorë

Kryetar

Brunilda Mersini